

# Hapet Thirrja për Bursa në Programin Erasmus + në Universitetin Alexandru Ioan Cuza të Iași, në Rumani



Mobility Project for Higher Education  
Students and Staff with Partner Countries

A jeni të interesuar të përfitoni nga bursat e Programit Erasmus +? Kjo është mundësia juaj! Sapo është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete në **Universitetin Alexandru Ioan Cuza të Iași, në Rumani**, për semestrin e parë të vitit akademik 2016-2017.

Programi Erasmus + është programi më i ri i lançuar nga Komisioni European, i cili u jep mundësinë studentëve për të zhvilluar aftësitë e tyre dhe rritur perspektivat e tyre të punësimit.

## Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime
- Shkëmbimin e stafit administrativ dhe akademik

## Nivelet e mobilitetit për studentët:

- **Bachelor** (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor në Universitetin e Tiranës. Nuk mund të aplikojnë dot studentët e regjistruar në vitin e parë por ata duhet të jenë të paktën të regjistruar në vitin e dytë të studimeve të tyre.)
- **Master** (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Master në Universitetin e Tiranës.)
- **Doktoraturë** (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi të doktoraturës në Universitetin e Tiranës.)

## Kohëzgjatja e bursave:

- Bachelor dhe Master (5 muaj);
- Doktoraturë (3-5 muaj)
- Stafi administrativ dhe akademik (5 ditë)

## Fushat e studimit:

- Histori dhe arkeologji;
- Filozofi dhe etikë;
- Edukim;
- Gjuhë të huaja;
- Shkenca sociale dhe të sjelljes (shkenca politike, sociologji, dhe studime kulturore, psikologji);

- Gazetari dhe raportim;
- Biznes dhe administrim (menaxhim dhe administrim, kontabilitet, financë, ekonomiks, marketing);
- Drejtësi;
- Shkenca të Biologjisë (biologji, biokimi);
- Shkenca të fizikës (kimi, fizikë, shkencat e tokës);
- Matematikë dhe statistikë;
- Teknologji informacioni dhe komunikimi

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin mujor (750 EUR në muaj)
- Kostot e udhëtimit

DISTANCA E UDHËTIMIT ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe / ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Për më shumë informacion vizitoni <https://erasmusplus.uaic.ro/funding>

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit BACHELOR:**

1. Kopje e Pasaportës;
2. CV (në gjuhën angleze);
3. [Learning Agreement](#)

*(Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni*

*përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “commitment” firmoset nga aplikanti dhe dy përfaqësues nga Universiteti i Tiranës*

*1. Nga koordinatori akademik që mund të jetë shefi juaj i departamentit, Zv.dekanë ose Dekani i fakultetit si edhe*

*2. Nga personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin e Tiranës, i cili është Drejtori i Drejtorisë së Komunikimit Z. Elton Skendaj.);*

4. Lista e notave e nivelit Bachelor (kopja origjinale në shqip dhe përkthimi i autorizuar në anglisht);

5. Vërtetim studentit, i cili konfirmon ciklin e studimit dhe vitin aktual akademik (kopja origjinale në shqip dhe përkthimi i autorizuar në anglisht);

6. Certifikata e Gjuhës së Huaj (për gjuhën në të cilën do të zhvillohet programi i studimit në universitetin pritës); Preferohet certifikatë e njohur ndërkombëtare e lëshuar nga Universiteti ose nga qendrat e gjuhëve të huaja;

7. Letra e Motivimit (plotësohet online në formën e aplikimit).

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit MASTER:**

1. Kopje e Pasaportës;

2. CV (në gjuhën angleze);

3. [Learning Agreement](#) (*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Mobility Plan”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “commitment” firmoset nga aplikanti dhe dy përfaqësues nga Universiteti i Tiranës*

*1. Nga koordinatori akademik që mund të jetë shefi juaj i departamentit, Zv.dekanë ose Dekani i fakultetit si edhe*

*2. Nga personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin e Tiranës, i cili është Drejtori i Drejtorisë së Komunikimit Z. Elton Skendaj.);*

4. Diploma e nivelit Bachelor (kopja origjinale në shqip dhe përkthimi i autorizuar në anglisht)

5. Suplementi i Diplomës Bachelor (kopja origjinale në shqip dhe përkthimi i autorizuar në anglisht)

6. Lista e notave e nivelit Master (kopja origjinale në shqip dhe përkthimi i autorizuar në anglisht)

7. Vërtetim studenti, i cili konfirmon ciklin e studimit dhe vitin aktual akademik (kopja origjinale në shqip dhe përkthimi i autorizuar në anglisht);

8. Certifikata e Gjuhës së Huaj (për gjuhën në të cilën do të zhvillohet programi i studimit në universitetin pritës); Preferohet certifikatë të njohura ndërkombëtare të lëshuara nga Universiteti ose nga qendrat e gjuhëve të huaja;

9. Letra e motivimit (plotësohet online në formën e aplikimit).

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e DOKTORATURËS:**

1. Kopje e Pasaportës;

2. CV (në gjuhën angleze);

3. [Learning Agreement](#) (*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "commitment" firmoset nga aplikanti dhe dy përfaqësues nga Universiteti i Tiranës*

*1. Nga koordinatori akademik që mund të jetë shefi juaj i departamentit, Zv.dekanë ose Dekani i fakultetit si edhe*

*2. Nga personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin e Tiranës, i cili është Drejtori i Drejtorisë së Komunikimit Z. Elton Skendaj.);*

4. Diploma e nivelit Bachelor (kopja origjinale në shqip dhe përkthimi i autorizuar në anglisht)

5. Suplementi i Diplomës Bachelor (kopja origjinale në shqip dhe përkthimi i autorizuar në anglisht)

6. Diploma e nivelit Master (kopja origjinale në shqip dhe përkthimi i autorizuar në anglisht)

7. Suplementi i Diplomës Master (kopja origjinale në shqip dhe përkthimi i autorizuar në anglisht)

8. Vërtetim i regjistrimit si student i doktoraturës në Universitetin e Tiranës, i cili konfirmon ciklin e studimit dhe vitin aktual akademik (kopja origjinale në shqip dhe përkthimi i autorizuar në anglisht);

9. Certifikata e Gjuhës së Huaj (për gjuhën në të cilën do të zhvillohet programi i studimit në universitetin pritës); Preferohet certifikatë të njohura ndërkombëtare të lëshuara nga Universiteti ose nga qendrat e gjuhëve të huaja;

10. Letra e motivimit (plotësohet online në formën e aplikimit).

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik dhe administrativ:**

1. Kopje e Pasaportës;

2. CV (në gjuhën angleze);

3. Vërtetim i punësimit në Universitetin e Origjinës (dokumenti origjinal dhe përkthimi zyrtar në gjuhën angleze);

4. Letra e Motivimit (plotësohet online në formën e aplikimit dhe duhet të specifikoni se aplikoni për një bursë në kuadër të Programit Erasmus+ dhe aktivitetet e planifikuara gjatë mobilitetit tuaj)

*5. Vërtetimit nga fakulteti juaj që ju lejon të shkëputeni gjatë kohës së mësimit për të kryer mobilitetin.*

Për t'u informuar rreth dokumentave që ju duhen për aplikim, ju lutem vizitoni linkun: <https://erasmusplus.uaic.ro/documents-to-be-uploaded>.

### **Afati për aplikim: 5 Nëntor 2016**

Për të aplikuar ju lutemi vizitoni: <https://erasmusplus.uaic.ro/application-form>

I gjithë procesi i aplikimit kryhet online.

Për më shumë informacion mbi bursat vizitoni: <https://erasmusplus.uaic.ro/> ose mund të na kontaktoni në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Ju urojmë shumë suksese në aplikimin tuaj!